



# KJO FLETUSHKË ËSHTË DEDIKUAR PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE:

## INFORMOHUNI PËR TË DREJTAT TUAJA DHE PËR MBËSHTETJEN, TË CILËN MUND TA MERRNI

Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të  
qenieve njerëzore në Serbi

### Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe



## Ç'ËSHTË TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE?

Trafikimi u qenieve njerëzore është vepër e rëndë penale dhe shkelje serioze e të drejtave të njeriut. Kjo vepër, si e tillë është e ndaluar me ligjet vendore dhe me të drejtën ndërkombëtare. Trafikimi i qenieve njerëzore është formë e skllavërimit modern. Kjo vepër penale konsiderohet e kryer, atëherë kur trafikanti i njerëzve, duke përdorë forcën, mashtrimin, apo kërcënimin, e kontrollon personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit seksual, për shfrytëzim pune (mobing), apo ndonjë formë tjetër të eksploatimit. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë në qytetin tuaj ku jetoni, por edhe në ndonjë vend apo shtet tjetër. Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore mund të konsiderohet madje edhe personi i cili, për shkaqe pune, fillimisht është pajtuar, ose nën masën detyrimit ka kryer ndonjë vepër penale në zinxhirin e trafikimit të qenieve njerëzore.

## SI TA KUPTONI QË EDHE JU MBASE JENI VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

Nëse dikush ju detyron (ose ju ka detyruar) që të punoni pa dëshirën dhe vullnetin tuaj, nën kushtet për të cilat nuk jeni pajtuar, apo nuk mundeni të largoheni me vullnetin tuaj, atëherë ju mund të jeni viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Nëse jeni gjendur aty derisa po kërkoni punë, apo po udhëtoni jashtë vendit, ose jeni gjendur në tjetër qytet për ndonjë arsye tjetër - është e mundur që ju kanë mashtruar apo lajthitur rreth natyrës dhe llojit të punës që do ta punoni dhe ua kanë marrë të hollat, pasaportën/letërnjoftimin, dhe përmes forcës apo kërcënimit se do ta përdorin forcën kundër jush, anëtarëve të familjes suaj, apo kundër të dashurve tuaj, ju kanë detyruar në gjendjen në situatë të tillë dhe të qëndroni në atë gjendje.

*Lluka (28 vjeçar) ka përfunduar Fakultetin e Ndërtimitarisë tashmë dy vjet dhe ende nuk ka mundur të gjejë punë. Ishte paraqitur në shpalljet, me të cilat kërkoheshin Inxhinier të ndërtimitarisë për punësim në Rusi. Ishte intervistuar nga ana e agjentit të firmës përkatëse me ç' rast kishte marrë të gjitha informatat lidhur me kushtet e punës, shumën e pagesës mujore, etj. Mirëpo, me të arritur në Rusi, shumica e kushteve nuk ishin të siguruara. Në vend të banesës, e kishin vendosur së bashku me 15 meshkuj tjerë në një banesë kolektive, të rrethuar me tel, kurse në hyrje të saj ishin rojet e armatosura. Në punishte të ndërtimitarisë punohej edhe nga 10 orë në ditë. Punëtorët që ishin aty, tashmë dy muaj nuk kishin marr kurrfarë pagese dhe kur me arsye ishin rebeluar, punëdhënësi ishte kërcënuar se "nëse nuk ulin kokë do të përfundonin në fontin e luftës në Çeçeni ose në burg, sepse nuk kishin dokumente". Mirëpo, Lluka kishte arritur të kthehej pas disa muajsh, kur kishte marrë pagën e cila ishte vetëm një e dhjeta e fitimit të premtuar.*

Si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ju keni të drejtat e caktuara dhe mund të merrni mbështetje, pa marr parasysh se a jeni shtetas/e i/e Serbisë apo jo dhe pavarësisht asaj se ku është kryer trafikimi me qenie njerëzore

## E DREJTA PËR TË QENË I INFORMUAR

Ju keni të drejtë të dini çdo gjë lidhur me statusin tuaj juridik, si dhe lidhur me të drejtat dhe procedurat, të cilat janë të rëndësishme për situatën tuaj. Gjithashtu, keni të drejtë të jeni të informuar për të gjitha llojet e programeve dhe ndihmave të cilat janë në dispozicionin tuaj.

## NDIHMA JURIDIKE

Ju keni të drejtë në ndihmë përkatëse juridike në të gjitha fazat procedurave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, gjë e cila do t'ju ndihmojë t'i kuptoni dhe realizon të drejtat dhe interesat tuaja.

*Ndonëse vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ndjeket zyrtarisht, sipas detyrës zyrtare (ex officio), ju keni të drejtë që avokati juaj të jetë i pranishëm në të gjitha fazat e procedurave, si dhe në të gjitha rrethanat dhe rastet kur ju jepni deklaratat (dëshmi) për të. Roli i avokatit tuaj është që të mbrojë të drejtat tuaja, t'ju informojë për rolin tuaj në procedurë, të mbrojë interesat tuaja dhe të sigurojë që pikëpamjet tuaja të jenë marrë në konsideratë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për realizimin e të drejtës së kompensimit të dëmit (të drejtën restorative).*

## NDIHMA E PËRKTHYESIT

Nëse nuk e flisni, apo nuk e kuptoni mirë gjuhën serbe, ju keni të drejtë në përkthyes, si dhe të gjitha informatat, para së gjithash ato që kanë të bëjnë me të drejtat tuaja t'ju jepen në gjuhën që ju e kuptoni .

*E drejta në përkthyes është e garantuar në mënyrë kumulative në komunikim me të gjitha institucionet dhe me ofruesit e shërbimeve, gjatë tërë kohës sa zgjatë rimëkëmbja juaj.*

*Në një kafene ku kishte punuar, Jellena (17 vjeçe), ishte njohur me një djalosh në të cilin ishte dashuruar. Ky djalosh kishte planifikuar të shkonte në Gjermani për të punuar tek i vëllai dhe e kishte pyetur Jellenën, a do të shkonte pas tij? Ai e kishte bindur atë se kjo do të ishte një rast ideal për ta të dy, sepse do të mund të shkonin së bashku, të fitonin të holla, e pastaj të ktheheshin në Serbi. Për të ishte më e rëndësishmja të jetë së bashku me djalin të cilin e donte, ndaj iku nga shtëpia dhe shkoi me të. Mirëpo, me të arritur në Gjermani, (në hotel), e kuptoi se ajo ishte shitur, sepse djaloshi me të cilin kishte ardhur, tashmë ishte zhdukur, dhe e kishte dhunuar një mashkull i panjohur, i cili i kishte thënë se është pronari i ri i saj. Ajo ishte detyruar të punonte si prostitutë dhe pas shumë muajsh, me rastin e një bastisjeje policore, ishte arrestuar dhe deportuar në Serbi.*

## E DREJTA NË PERIUdhË TË RIMËKËMBJES DHE REFLEKSIONIT

*Ju keni të drejtën në një periudhë tremujore për rimëkëmbje dhe refleksion. Kjo do të thotë, një periudhë kohore e cila ju duhet për të filluar rimëkëmbjen dhe për të vendosur a dëshironi të bashkëpunoni me policinë. Në këtë periudhë kohore keni të drejtë për krejt ndihmën e cila ju nevojitet.*

*Askujt nuk i lejohet të ushtrorë presion mbi ju për të marrë pjesë në zbulimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve të qenieve njerëzore dhe ndihmësve të tyre, mirëpo nëse e paraqitni rastin, atëherë jeni të obliguar të merrni pjesë në procedurën penale si dëshmitar.*

## E DREJTA PËR QËNDRIM HUMANITAR – NËSE NUK JENI SHTETAS/E I/E

Serbisë dhe qëndrimi juaj në Serbi nuk është rregulluar në ndonjë mënyrë tjetër, atëherë, policia, për arsye humanitare, mund t'ju lejojë një qëndrim të përkohshëm.

*Pra, mund të fitoni një qëndrim të përkohshëm deri në 90 ditës pa kushtëzime, ose një vit nëse vendosni të bashkëpunoni me policinë dhe organet gjyqësore në hetime dhe në procedura penale kundër trafikantëve, apo personave tjerë të cilët kanë marrë pjesë në shfrytëzimin tuaj. Të drejtën për qëndrim humanitar e keni edhe nëse kthimi juaj në vendin amë do të paraqiste rrezik për shëndetin apo sigurinë tuaj. Madje, në situata të tilla, ju mund të kërkonti edhe strehim. Nëse keni lejen e përkohshme të banimit, ju mund të lëvizni lirisht dhe të punoni në Serbi.*

## E DREJTA NË PRIVATËSI

Ju keni të drejtë në mbrojtje të privatësisë dhe identitetit tuaj. Askush nuk guxon të zbulojë të dhënat tuaja private pa pëlqimin tuaj. Prokurori publik dhe avokati juaj mund të kërkojnë që gjykimi në të cilin ju merrni pjesë si dëshmitar të jetë i mbyllur për publikun.

## GARANTIMI DHE MBROJTJA E SIGURISË SUAJ SI DËSHMITAR/E, APO I/E DËMTUAR

Nëse vendosni të dëshmoni në procedurë penale, atëherë ju keni të drejtë të jeni dëshmitar i mbrojtur dhe ndaj jush të veprohet me dinjitet dhe respekt. Gjithashtu, mund të kërkonti edhe statusin e dëshmitarit shumë të ndjeshëm.

*Policia dhe gjykata janë të obliguar t'ju mbrojnë nga kërcënimet, fyerjet, frikësimet dhe çfarëdo sulmi tjetër, gjatë, e pas hetimit dhe gjykimit. Nëse është e domosdoshme, gjykata mund të kërkojë nga policia që të zbatojë masat e posaçme mbrojtëse. Prokurori publik dhe avokati juaj mund të kërkojnë që t'ju ndahet statusi i dëshmitarit shumë të ndjeshëm, për shkak të moshës suaj, përjetimeve, (eksperiencave), gjendjes shëndetësore dhe për shkak të rrethanave tjera. Kjo do të thotë se ju mund të dëshmoni nën kushte të posaçme (pa u ballafaquar me trafikantin, në dhoma të ndara, përmes video-linkut, etj.).*



## E DREJTA NË KOMPENSIM

Ju keni të drejtën në kompensim të dëmit të cilin e keni pësuar në zinxhirin e trafikimit të qenieve njerëzore, i cili nënkupton dëmin material, vuajtjet shpirtërore, frikën, shkeljen e lirisë, respektit, nderit, personalitetit, dinjitetit, etj.

### KOMPENSIMIN MUND TA KËRKONI NË DY MËNYRA:

#### ***NË PROCEDURËN PENALE:***

avokati juaj gjithmonë duhet ta theksoj kërkesën pronësore juridike, në të cilën duhet të jetë qartë e cekur shuma e kompensimit të cilën e kërkon. Ju gjithsesi merrni pjesë si dëshmitar/i dëmtuar në procedurën penale. Ndërkaq, prokurori publik, derisa mbledh provat kundër trafikantit të qenieve njerëzore, mund të mbledh edhe provat që vërtetojnë dëmin jo material, (por nuk i obliguar), të cilin e keni pësuar. Mirëpo, gjykata në praktik zakonisht e udhëzon viktimën që të drejtën e kompensimit ta realizojë përmes procedurës kontestimore.

#### ***NË PROCEDURËN KONTESTIMORE:***

avokati juaj ngre padi kundër trafikantit përkatës për kompensim të dëmit. Në procedurën kontestimore ju keni rolin e paditësit, ndaj nuk mund të keni status të dëshmitarit tepër të ndjeshëm sikurse në procedurën penale. Zakonisht duhet të kaloni sërish nëpër ekspertizë të cilën e keni kaluar në procedurën penale dhe të jepni dëshmitë për atë që ju ka ndodhur,

gjegjësisht të dëshmoni me prova se keni pësuar dëme në përgjithësi. Këtë procedurë mund ta iniciojë secili që konsiderohet i dëmtuar në afat prej 3 vjetësh nga pësimi i dëmit, ose nëse dëmi është shkaktuar me vepër penale, në afatin në të cilin parashkruhet ndjekja penale apo vetëm vepra e tillë.

Nëse vendosni që të inicioni procedurën kontestimore, atëherë drejtohuni për mbështetje organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë ndihmë për viktimat e tilla.



*Pas gjashtë muajsh prostitucioni të detyrueshëm, policia e kishte ndihmuar Millicën që të shpëtojë nga trafikanti. Ajo ishte kthyer në shtëpi. Ndjehej e turpëruar. Nuk kishte mbështetjen e familjes. Mirëpo, në kontakte me shërbimet e shtetit dhe me organizatat joqeveritare filloi të rimëkëmbet dhe shërohet, sepse i ofruan ndihmë psikologjike, angazhuan terapeutin, i ndihmuar të përfundojë shkollimin si jo e rregullt dhe i ofruan ndihmën e domosdoshme juridike në procedurat gjyqësore. Gjykimi ka zgjatur tre vjet e gjysmë, por ajo e kishte një avokate e cila gjithmonë i ka qëndruar pranë. Gjykimi nuk ishte i lehtë, por në fund trafikantët e kishin marrë dënimin. Pastaj, ajo falë ndihmës që e kishte, iniciojë edhe procedurën kontestimore dhe arriti të marr kompensimin e dëmit, i cili nuk ishte ndonjë shumë e madhe të hollash, por megjithatë arriti të kthej borxhet dhe të hapë një punëtori dhe po përpiqet të përmirësojë jetën.*

## **E DREJTA NË KTHIM (RIATDHESIM)**

Nëse ju dëshironi ose duhet të ktheheni në shtetin e origjinës ku keni jetuar para se të vini në Serbi, atëherë organet shtetërore të Serbisë janë të obliguara të mundësojnë kthimin tuaj pa kurrfarë të paarsyeshme dhe të panevojshme, duke u kujdesur njëherazi edhe për sigurinë tuaj.



*Nëse ju nuk i keni dokumentet e domosdoshme, atëherë organet e shtetit tuaj janë të obliguara t'ua lëshojnë ato në mënyrë që ju të mund të ktheheni.*

## **NDIHMA PSIKOLOGJIKE**

Përvojat e trafikimit të qenieve njerëzore tregojnë se përjetimet e tilla mund të shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin mendor të viktimës. Për të luftuar më lehtë ato probleme dhembjeje, frike dhe emocionet tjera negative, ju keni të drejtën e ndihmës psikologjike në mënyrën e cila ju përgjigjet juve – nga mbështetja dhe këshillat psikologjike deri te psikoterapia, e cila do t'ju ndihmojë që sërish të merrni kontrollin mbi jetën tuaj personale dhe të jetoni ashtu siç dëshironi.

## **NDIHMA MJEKËSORE**

Ju keni të drejtën në shërbime shëndetësore falas, të cilat janë të përfshira në pakon e sigurimeve të domosdoshme shëndetësore, pa marrë parasysh se a jeni, apo jo, shtetas/e i/e Serbisë.

*Organizatat joqeveritare mund të mbulojnë shpenzimet e shërbimeve shëndetësore, kontrolleve mjekësore, procedurave dhe barërave, madje edhe atëherë kur ju nuk e keni sigurimin shëndetësor, ose kur juve ju duhet ndonjë shërbim shëndetësor më shpejt se sa që ai mund të merret në sistemin shtetëror të mbrojtjes shëndetësore.*

## STREHIMIS

Nëse nuk keni ku të jetoni, ose nuk ka siguri për kthimin tuaj në shtëpi, ju keni të drejtë në strehim në strehimoren për viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, ose në ndonjë strehim alternativ. Nëse jeni i moshës jo madhore, apo person tepër i ri, atëherë mund të fitoni strehim duke u vendosur në familje ushqyese.

*Strehimin në institucionet shtetërore të mbrojtjes sociale e organizon Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Organizatat joqeveritare, të cilat iu ofrojnë ndihmë viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nganjëherë ofrojnë mundësi për jetë të pavarur duke ju mbështetur dhatë një periudhe kohore, e cila ju nevojitet për që gjetur punën nga e cila do të mbani vetveten.*

## (RI)INTEGRIMI DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ju, keni të drejtë në informata për të gjitha programet të cilat ju ndihmojnë kthimin në jetën e përditshme normale dhe të cilat ofrojnë aktivitete të ndryshme, kurse dhe arsimim, ndihmë në kërkim dhe gjetje të punës, si dhe ndihmë për të gjetur dhe për tu përfshirë në programe të cilat iu përgjigjen nevojave tuaja.

*Programe të tilla, zakonisht zhvillojnë dhe udhëheqin organizatat joqeveritare. Çdo aktor i cili ju ofron ndihmë dhe përkrahje është i obliguar që t'ju njoftojë dhe informojë për programet e (ri)integritit dhe për përfshirjet sociale të cilat ekzistojnë. Ez a prospektus nem jogi tanácsadásra szolgál, és nem helyettesíti a jogi tanácsot.*



Kjo broshurë nuk shërben si këshillë juridike dhe nuk është zëvendësim për kërkim të ndihmës juridike.

Broshura është përgatitur me ndihmën e mjeteve të përbashkëta të Bashkësisë Evropiane dhe të Këshillit të Evropës. Qëndrimet e cekuar në të, kurrsesi nuk shprehin qëndrimet e Këshillit të Evropës, as të Bashkësisë Evropiane.

# NËSE KENI EDHE NDONJË PYETJE APO JU DUHET NDIHMË DHE MBËSHTETJE, MUND TË THIRRNË:

## Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Telefon:

+381 63 610 590

centar@centarzztlj.rs

www.centarzztlj.rs



## OJQ AKTQNJ – Aksioni Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

SOS telefon: 011/785-0000

0800 101 201\*

e-mail: sos@astra.rs

www.astra.rs



\*NUMRI PA PAGESË (VETËM PËR THIRRUET NGA SERBIA)

## Ministria e Punëve të Brendshme Drejtoria e Policisë Departamenti i policisë kriminalistike

Telefon:

+381 11 247 1019

+381 64 724 1019

ukp@mup.gov.rs



## OJQ "Athina"

Telefon:

+381 61 63 84 071

e-mail: office@atina.org.rs

www.atina.org.rs



Këshilli i Evropës është organizatë udhëheqëse e të drejtave të njeriut në kontinent. Atë e përbëjnë 47 shtete anëtare, prej të cilave, 28 janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik i 28 vendeve demokratike Evropiane. Qëllimet e tij janë që të sigurojë paqe, prosperitet dhe liri për 500 milionë qytetarë të tij dhe një botë më të drejtë dhe më të sigurt. Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave, vendet e BE-së kanë themeluar organe, të cilat e udhëheqin Bashkimin Evropian dhe miratojnë legjislacionin e tij. Organet kryesore të tij janë: Parlamenti Evropian (i cili i përfaqëson qytetarët e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (i cili i përfaqëson qeveritë e shteteve anëtare) dhe Komisioni Evropian (i cili i përfaqëson interesat e përbashkëta të Bashkimit Evropian).

<http://europa.eu>

### Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented  
by the Council of Europe

SQI